

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

## Pëmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e performancës financiare .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto .....	3
Pasqyra e flukseve monetare .....	4
Shënime të pasqyrave financiare.....	5

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Transcom WorldWide Albania Shpk

Raport për auditimin e pasqyrave financiare

### Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Transcom WorldWide Albania Shpk ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat e auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Transcom WorldWide Albania Shpk, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

### Raport për Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2019 të Transcom WorldWide Albania Shpk

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2019, përgatitur në përputhje me nenet 17, 18, dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2019 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale.

Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këto fakt.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

*Ernst & Young Certified Auditors*

3 shkurt 2021  
Tiranë, Shqipëri




Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**


(Shumat në Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalent me to	7	14,592,830	8,498,265
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	8	146,663,469	114,581,984
Të arkëtueshme të tjera	10	9,820,371	3,775,453
Shpenzime të shtyra	9	2,433,085	1,286,701
<b>Totali i aktive afatshkurtra</b>		<b>173,509,755</b>	<b>128,142,403</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktivet afatgjata të trupëzuara	6	24,971,487	25,802,410
Aktive afatgjata jo të trupëzuara	6	233,814	275,691
Aktive me të drejtë përdorimi	6.1	58,992,327	-
Emri i mirë	6	100,146,004	100,146,004
<b>Totali i aktive afatgjata</b>		<b>184,343,632</b>	<b>126,224,106</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>357,853,387</b>	<b>254,366,509</b>
<b>Detyrime</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	11	23,332,663	10,734,959
Të pagueshme të tjera	12	40,448,365	38,375,344
Hua	13	-	129,591,000
Detyrime qiraje	14	18,189,028	-
Tatim mbi fitimin	16	9,801,291	9,554,576
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>91,771,347</b>	<b>188,255,879</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime qiraje	14	41,900,448	-
<b>Detyrimet afatgjata</b>		<b>41,900,448</b>	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>133,671,795</b>	<b>188,255,879</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar	15	1,271,700	1,271,700
Fitim i pashpërndarë	15	64,838,930	-
Fitimi i vitit	17	158,070,962	64,838,930
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>224,181,592</b>	<b>66,110,630</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>357,853,387</b>	<b>254,366,509</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga drejtimi i Transcom Worldwide Albania shpk më 30 nëntor 2020 dhe u nënshkruan në emër të saj nga:

  
 Gianluca Gemma  
 Përfaqësues ligjor

**Transcom WorldWide Albania Sh.p.k**  
 NUIS : L 81808502 Q  
 Rr.Taulantia , Kati 2 , Lagja 1,  
 D U R R E S

  
 PwC Consulting shpk  
 Hartues i pasqyrave financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 22.

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse**  
**për periudhën më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha nga 31 maj më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga kontratat me klientët	17	702,784,013	315,752,417
Të ardhura të tjera	17	42,717	-
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>702,826,730</b>	<b>315,752,417</b>
Shpenzime për personelin	18	(430,640,672)	(207,056,566)
Shpenzime amortizimi	6	(24,011,033)	(1,787,516)
Shpenzime të tjera operative	19	(55,196,205)	(28,803,496)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>192,978,820</b>	<b>78,104,839</b>
Shpenzime interesi	20	(4,546,328)	(2,288,154)
(Humbje)/fitim nga kursi i këmbimit, neto	20	(3,363,396)	576,821
<b>Shpenzime financiare, neto</b>		<b>(7,909,724)</b>	<b>(1,711,333)</b>
<b>Fitimi përpara tatimit</b>		<b>185,069,096</b>	<b>76,393,506</b>
Tatim mbi fitimin	16	(26,998,134)	(11,554,576)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>158,070,962</b>	<b>64,838,930</b>

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 22.

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lekë)

	<u>Kapitali i nënshkruar</u>	<u>Fitimi i akumuluar</u>	<u>Totali</u>
Gjendja me 31 maj 2018	1,271,700	-	1,271,700
Fitimi i vitit	-	64,838,930	64,838,930
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,271,700</b>	<b>64,838,930</b>	<b>66,110,630</b>
Fitimi i vitit	-	158,070,962	158,070,962
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,271,700</b>	<b>222,909,892</b>	<b>224,181,592</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 22.

**Transcom WorldWide Albania Sh.p.k.**  
**Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese</b>			
Fitimi para tatimit		185,069,096	76,393,506
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizim	6	24,011,033	1,787,516
Shpenzime të përlllogaritura për faturat e pambërritura dhe interesi		(4,610,753)	-
Shpenzime Interesi sipas IFRS 16		4,540,229	-
Diferenca nga rivlerësimi		(952,958)	-
		<b>208,056,647</b>	<b>78,181,022</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Ndryshime në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8,10	(38,126,403)	(118,357,437)
Parapagime	9	(1,146,384)	(1,286,701)
Ndryshime në llogari të pagueshme dhe të tjera	11,12	19,528,193	58,664,879
		<b>(19,744,594)</b>	<b>(60,979,259)</b>
<b>Tatim fitim i paguar</b>	17	<b>(26,998,134)</b>	<b>(11,554,576)</b>
<b>Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>161,313,920</b>	<b>5,647,187</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje të aktiveve afatgjata të trupëzuara	6	(3,948,679)	(27,865,618)
Emri i mirë	6	-	(100,146,004)
<b>Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese</b>		<b>(3,948,679)</b>	<b>(128,011,622)</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>			
Kapitali aksionar	15	-	1,271,700
Pagesa të qirasë financiare	14	(21,679,675)	-
Disbursim i huasë	13	-	129,591,000
Pagesë e huasë	13	(129,591,000)	-
<b>Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese</b>		<b>(151,270,675)</b>	<b>130,862,700</b>
Rritja e mjeteve monetare dhe ekuivalent me to		6,094,565	8,498,265
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		8,498,265	-
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor</b>		<b>14,592,830</b>	<b>8,498,265</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 dhe 22.



## **1. HYRJE**

Transcom Worldwide Albania sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 8 qershor 2018 nën formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT L81808502Q.

Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm, Transcom WorldWide AB i cili ka nënshkruar një kapital fillestar prej 1,271,700 Lekë.

Shoqëria e ushtron aktivitetin në adresën Rr “Taulantia”, Lagjia 1, Durrës. Objekti i aktivitetit së Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve telefonike për të tretë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë në 31 dhjetor 2019 është 537 (2018: 561).

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në mbështetje të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, një subjekt mund të klasifikohet i rëndësishëm për interesin e publikut (PIE) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre. Bazuar në pikën IV të këtij vendimi, Transcom Worldwide Albania klasifikohet si PIE për shkak të plotësimit të kriteveve.

## **2. BAZA E KONTABILITETIT**

### **a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

### **b) Baza e përgatitjes financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Politikat kryesore kontabël paraqiten më poshtë.

### **c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë shqiptar (Lekë), që është dhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme për shkak të këtyre çmuarjeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Vecanerishte, informacioni në lidhje me vlerësimet me te rëndësishme te kontabilitetit dhe gjykimet që lidhen me zbatimin e politikave kontabël të cilat ndikojnë në shumat të konsiderueshme në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet shpjeguese.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

#### a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi 2019	Kursi 2018
Kursi mesatar i vitit Lekë/ Euro	123.00	127.59
Kursi i fund vitit Lekë/ Euro	121.77	123.42

#### b) Të ardhura nga kontratat me klientët

Shoqëria ofron shërbime suporti me anë të linjës telefonike në gjuhë të ndryshme për të tretë. Me specifikisht, Transcom ofron shërbime të kujdesit ndaj klientit dhe mbështetje teknike nëpërmjet kanaleve të ndryshme si: telefonit e-mail, chat-it etj. Ky shërbim ofrohet kryesisht në industri si: media dhe telekomunikacion, e-commerce, logjistike, shitje me pakice.

Të ardhurat njihen në një shumë që reflekton shumën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të shërbimeve për konsumatorët e saj (sipas SNRF 15). Transaksionet e shoqërisë janë me palën e lidhur, për këtë arsye nuk ka pasiguri për ofrimin e shërbimit.

SNRF 15 është zbatuar nga Shoqëria në pasqyrat financiare sic shpjegohet më poshtë:

- *Modifikimet e kontratës*: Shoqëria nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratave lidhur me qëllimin ose shumën korresponduese të kontratës.
- *Detyrimet shtesë të performancës të identifikuar*: Në përgjithësi, Shoqëria siguron vetëm një detyrim të veçantë të performancës që lidhet me shërbimin e suportit me anë të linjës telefonike në gjuhë të ndryshme.
- *Shuma të ndryshueshme*: Çmimi i transaksionit nuk bazohet në shumën e ndryshueshme.
- *Komponentë të rëndësishëm të financimit*: Shoqëria nuk ka dhe nuk pret që të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti tejkalon një vit.
- *Programet e besnikërisë ndaj klientit*: Shoqëria nuk zbaton ndonjë program besnikërie.
- *Përcaktimi i kohës së njohjes së të ardhurave (njohja përgjatë kohës ose njohja në një moment të caktuar kohor)*: Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen, pra në një moment të caktuar kohor.
- *Rimbursimet*: Shoqëria nuk zbaton rimbursime.
- *Kostot shtesë të marrjes së një kontratë*: Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto shtesë për të marrë një kontratë.
- *Kostot për të realizuar një kontratë*: Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto për të realizuar një kontratë.
- *Kushtet e arketimit të të ardhurave*: Faturmi i shërbimit behet në baze mujore dhe termat e pagesave janë 30-60 ditë nga momenti i lëshimit të fatures.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### b) Të ardhura nga kontratat me klientët (vazhdim)

##### Balancat kontraktuale

###### *Aktivitet kontraktuale*

Një aktiv kontraktual është e drejta në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të transferuara tek konsumatori. Nëse Shoqëria operon duke transferuar shërbimet tek konsumatori përpara se ky i fundit të paguajë ose përpara afatit të pagesës, një aktiv kontraktual njihet në vlerën e pretendimit të përfituar, e cila është e kushtëzuar.

###### *Llogari të arkëtueshme*

Një llogari e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë ndaj vlerës së një pretendimi të pakushtëzuar (që do të thotë se kërkohet vetëm kalimi i kohës në mënyrë që pagesa e pretendimit të jetë i pagueshëm).

###### *Detyrimet kontraktuale*

Një detyrim kontraktual është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime tek një konsumator për të cilin Shoqëria ka marrë një pretendim (ose një pretendim është i pagueshëm). Nëse konsumatori paguan pretendimin përpara se Shoqëria të transferojë mallrat ose shërbimet tek ky i fundit, njihet një detyrim kontraktual në momentin që pagesa është bërë ose kur detyrimi është i pagueshëm (cilado të jetë më e hershme). Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura kur Shoqëria vepron sipas kontratës. Shoqëria nuk merr parapagime nga kontratat me klientet dhe si rrjedhojë nuk ka detyrime të kontrates.

#### c) Përfitimet e punonjësve

###### *Sigurimet shoqërore të detyrueshme*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ndodhin.

###### *Leje vjetore*

Të gjithë punonjësit e Shoqërisë, sipas legjislacionit aktual vendor, kanë të drejtë të paguhen për leje vjetore të papërdorur në rast se kontrata e punës është ndërprerë. Shoqëria nuk regjistron një provision për leje vjetore të papërdorur edhe pse është e mundur të vlerësohen me besueshmëri pagesa të mundshme për punonjësit për pushimin vjetor të papërdorur në përfundimin e marrëdhënies së punës. Lejet e papërdorura në fund të vitit 2019 parashikohet të perdoren nga punonjësit deri në datën 31 mars të vitit pasardhës dhe Shoqëria nuk do duhet të kompensojë financiarisht këto shume.

#### d) Të ardhurat dhe shpenzime financiare

Të ardhurat (shpenzimet) financiare neto përbëhen nga shpenzimet e interesit dhe nga fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të përealizuara nga këmbimet valutore, të cilat raportohen neto në këto pasqyra financiare.

#### e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi-fitimi njihet në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit. Një tatim i shyrë njihet deri në atë vlerë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivitetet e njohura nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### f) Aktivet afatgjata të trupëzuara

##### *Njohja dhe vlerësimi*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

##### *Kostot e zëvendësimit*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot që rrjedhin nga përdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

##### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet në mënyrë që të shpërndahet kosto e aktivitetit e pakësuar me vlerën parashikuar të mbetur të tij duke përdorur metodën lineare mbi jetën e vlerësuar të dobishme. Aktivitetet me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe e jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuara për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

• Pajisje zyre	5 vjet
• Mobilje	5 vjet
• Pajisje informatike	7 vjet

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen çdo datë raportimi dhe korrigojnë nëse është e nevojshme.

#### (f) Aktivet afatgjata jo të trupëzuara

Aktivitetet afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria, të cilat përfshijnë programe kompjuterike (software) janë regjistruar me kosto të pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin (në rastin kur aplikohet). Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata jo të trupëzuara për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

• Program kompjuterik	7 vjet
-----------------------	--------

#### (g) Emri i mirë

Emri i mirë është krijuar nga transferimi i aktivitetit që Shoqëria ka kryer sipas marrëveshjes së datës 28 qershor 2018. Marrëveshja e transferimit konsiston në transferimin e të gjithë asetëve të Shoqërisë së mëparshme Nethex, kontratave të punonjësve edhe disa kontrata me furnitorët, ndër të cilat më e rëndësishmja kontrata e ambjentëve me qira. Vlera e drejte e aktiveve të identifikueshme që rezultoi të ishte vetëm aktiviteti i trupëzuara, në total përbëjnë Lekë 22,242,000. Transferimi i aktivitetit është kryer me një çmim prej 950,000 Euro ose Lekë 119,607,000. Emri i mirë është krijuar si diferencë e çmimit të blerjes me aktivitetin, duke shtuar edhe të gjitha shpenzimet ligjore dhe materiale për arritjen e marrëveshjes së transferimit të aktivitetit. Emri i mirë i njohur është Lekë 100,146,004.

Për qëllime fiskale, Shoqëria ndjek politikën e zhvlerësimit të emrit të mirë në masën 15%.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (h) Instrumentet financiare

Një instrument financiar është cdo kontratë që sjell një aktiv financiar për një shoqëri dhe një detyrim financiar ose instrumenta të kapitalit për një shoqëri tjetër. Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë, përfshijnë llogari të arkëtueshme, para dhe ekuivalente me të, llogari të pagueshme dhe kredi bankare dhe hua të tjera. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit apo instrumenta borxhi në vazhdimësi të aktivitetit.

#### *Njohja fillestare*

Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohej më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

#### *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Mjetet monerate dhe ekuivalentet me to fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

#### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogari të pagueshme fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

#### **Zhvlerësimi**

Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivitetet e mbetura financiare janë vlerësuar së bashku në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditimit. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në rast se rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me ngjarje që ndodhin pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerat në pasqyrat financiare të Shoqërisë për aktivet jofinanciare, përveç të drejtave tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për humbje të pritshme kreditore.

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF 9 se një aktiv financiar konsiderohet borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 dite me vonese, megjithatë gjykimi behet rast pas rasti në varesi të kerkedave të likuiditetit të paleve të lidhura. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionimi në të cilën llogariten kostot e humbjeve për llogaritë e arkëtueshme që i perkasin periudhave të ndryshme të maturimit ose vonesës.

Shoqëria ka vetëm një klient, që është Transcom Worldwide Italy. Termat e pagesës janë 30-60 dite. Duke marrë në konsideratë që klienti është një pale e lidhur dhe bazuar në historikun e arkëtimit deri me tani, Shoqëria gjykon që humbja e pritshme e kredisë është zero dhe nuk parashikohet të kemi një zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme.

Si rrjedhim, Shoqëria nuk ka krijuar një matricë provigjoni duke qene se nuk ka një historik humbjesh edhe duke marr parasysh efektin e faktoreve të ardhshëm.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (j) Provigjonef

Një provigjon njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një dalje e flukseve të të mirave ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjonet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

#### (k) Qiratë

*Politikat kontabël para 1 Janar 2019*

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira ose mbajtje qiraje, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkohej një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi specifik ose nëse angazhimi përcjell një të drejtë për përdorimin e një aktivi. Qiratë të cilat nuk i transferojnë Shoqërisë të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e sendeve të marra me qira janë qira operative. Të pagueshmet nga këto qira njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato ndodhin.

*Politikat kontabël pas 1 Janar 2019*

Shoqëria vlerëson në fazën fillestare të lidhjes së një kontrate, nëse kontrata është, ose përmban një qira. Kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Shoqëria përdor një qasje të vetme për njohjen dhe matjen e të gjitha qirave, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Shoqëria njeh detyrimet ndaj qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe të drejtën e përdorimit të aktiveve, e cila paraqet të drejtën për ta përdorur aktivin.

Shoqëria ka njohur: (a) aktivet dhe detyrimet për qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Zbatimi për herë të parë i SNRF 16 nga Shoqëria është paraqitur në shënimin 3(1). SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por tek Shoqëria nuk ka impakt.

*Matja fillestare e aktivitetit me të drejtë përdorimi*

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi do të përfshijë:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;
- çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitetit bazë

*Matja fillestare e detyrimit të qirasë*

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

*Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi*

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos dhe e amortizon vlerën e asetit gjatë jetegjatesisë së pritshme të kontrates.

*Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë*

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

### 3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### (I) Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Shoqëria zbatoi SNRF 16 për herë të parë. Natyra dhe efektet e aplikimit të këtyre standardeve të reja përshkruhen më poshtë. Përveç ndryshimeve të përshkruara më poshtë politikat kontabël të zbatuara janë në vijueshmëri me ato të aplikuara në vitin e kaluar financiar.

Interpretime dhe ndryshime të tjera janë të zbatueshme për herë të parë në vitin 2019 por ato nuk kanë efekt në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka zbatuar më herët ndonjë standard, interpretim apo ndryshim të publikuar por që ende nuk ka hyrë për zbatim.

#### *Zbatimi i SNRF 16 "Qirate"*

Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin nga data e tij e zbatimit të detyrueshëm, 1 janar 2019, duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shumave krahasuese. Detyrimi i qirasë në datën e zbatimit fillestar është në shumën prej 78,181,880 Lekë dhe matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat janë ende të papaguara. Pagesat e qirasë janë skontuar me normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Norma e interesit përdorur nga Shoqëria për llogaritjet e SNRF 16 është 6.5%. Aktivitetet me të drejtë përdorimi janë matur në tranzicion në shumën e detyrimit të qirasë 78,181,880 Lekë. Impakti i SNRF 16 në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin 2019, paraqitet në shënimet 6 (aktivitetet me të drejtë përdorimi dhe amortizimi), 14 (detyrimi i qirasë), 21 (shpenzimi i interesit).

Tabela në vijim paraqet një rikoncilim të angazhimeve të qirasë operative në 31 dhjetor 2018 dhe detyrimin e qirasë më 1 janar 2019 së bashku me efektin e skontimit.

	<b>1 janar 2019</b>
Pagesat totale minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të pa-anullueshme	89,225,995
- Pagesat e ardhshme të qirasë përfshirë opsionin e zgjatjes së periudhës së qiramarrjes	78,181,880
- Pagesat e ardhshme të qirasë së ndryshueshme që bazohen në një indeks ose një normë	-
- Efekti i skontimit në vlerën aktuale	11,044,115

#### *Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2019, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:*

- KIRFN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja" (publikuar më 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshime në SNK 28, "Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta" (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 "Përmirësime vjetore të SNRF-ve për ciklin 2015-2017" (publikuar në 12 dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

Ndryshimet që mund të jenë të rëndësishme për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj, janë paraqitur më poshtë:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar në 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në SNRF 3 "Përkufizimi i një biznesi" (publikuar në 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet e bëra për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Ndryshime në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7 "Studim krahasueshmërie për reformën e normës së interesit" (publikuar më 26 shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata-Ndryshime në SNK 1 (publikuar në 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

### **4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE**

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmerite e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme për rrethanat. Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël.



## 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Shoqëria ka ekspozim ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të kompanisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme sasiore përfshihen në këto pasqyra financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet Shoqëria, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga paratë e gatshme në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huatë dhe detyrimet e tjera.

### (i) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë ekziston nëse palët nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre të pagesave për të arkëtueshmet.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2019 është paraqitur më poshtë:

	2019	2018
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	156,483,840	118,357,437
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14,592,830	8,498,265
<b>Totali</b>	<b>171,076,670</b>	<b>126,855,702</b>

Shoqëria vlerëson si të kënaqshme cilësinë e kredisë së të arkëtueshmeve që nuk janë as të vonuara as të zhvleresuara. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë të arkëtueshme nga shoqëria mëmë.

### (ii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare në afat. Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe nën rastet e vështirësisë financiare, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

2019	Më pak se 3 muaj	Nga 3 muaj deri në 6 muaj	Nga 6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	146,663,469	-	-	9,820,371	156,483,840
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14,592,830	-	-	-	14,592,830
<b>Totali</b>	<b>161,256,299</b>	-	-	<b>9,820,371</b>	<b>171,076,670</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	(63,781,028)	-	-	-	(63,781,028)
Tatim fitimi i pagueshëm	(9,801,291)	-	-	-	(9,801,291)
Detyrimi i qirasë	(4,547,316)	(4,547,316)	(9,094,397)	(41,900,448)	(60,089,476)
<b>Totali</b>	<b>(73,582,319)</b>	-	<b>(18,189,028)</b>	<b>(41,900,448)</b>	<b>(60,089,476)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019</b>	<b>87,673,980</b>	-	<b>(18,189,028)</b>	<b>(32,080,077)</b>	<b>37,404,875</b>

**5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

*(ii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)*

2018	Më pak se 3 muaj	Nga 3 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Llogari të arketueshme dhe të tjera	118,357,437	-	-	118,357,437
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8,498,265	-	-	8,498,265
<b>Totali</b>	<b>126,855,702</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>126,855,702</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	(49,110,303)	-	-	(49,110,303)
Tatim fitimi i pagueshëm	(9,554,576)	-	-	(9,554,576)
<b>Totali</b>	<b>(58,664,879)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(58,664,879)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018</b>	<b>68,190,823</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>68,190,823</b>

*(iii) Rreziku i tregut*

*Rreziku i normës së interesit*

Shoqëria nuk ka instrumente financiare me interes më 31 dhjetor 2019.

*Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë dhe Euro. Rreziku i monedhës menaxhohet përmes përdorimit të parimeve të përputhjes së aktiveve/detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë këmbim të ardhshëm ose transaksione të produkteve të derivativëve të përfshirë më 31 dhjetor 2019.

2019	EUR	ALL	Totali
<b>Aktive financiare</b>			
Llogari të arketueshme dhe të tjera	146,663,496	9,820,371	156,483,840
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	14,282,238	310,592	14,592,830
<b>Totali</b>	<b>160,945,707</b>	<b>10,130,963</b>	<b>171,076,670</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	(19,867,139)	(3,465,523)	(23,332,662)
Detyrimi i qirasë	(60,089,476)	-	(60,089,476)
Tatim fitimi i pagueshëm	-	(9,801,291)	(9,801,291)
<b>Totali</b>	<b>(79,956,615)</b>	<b>(13,266,814)</b>	<b>(93,223,429)</b>
<b>Risku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019</b>	<b>80,989,092</b>	<b>(3,135,851)</b>	<b>77,853,241</b>

**5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

*(iii) Rreziku i tregut (vazhdim)*

2018	EUR	ALL	Total
<b>Aktive financiare</b>			
Llogari të arkëtueshme	114,581,984	-	114,581,984
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	8,186,384	311,880	8,498,265
<b>Totali</b>	<b>122,768,368</b>	<b>311,880</b>	<b>123,080,249</b>
<b>Detyrime financiare</b>			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	6,885,563	(42,224,740)	(49,110,303)
Tatim fitimi i pagueshëm	-	(9,554,576)	(9,554,576)
<b>Totali</b>	<b>6,885,563</b>	<b>(51,779,316)</b>	<b>(58,664,879)</b>
<b>Risku i kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2018</b>	<b>115,882,805</b>	<b>(51,476,436)</b>	<b>64,415,370</b>

## 6. AKTIVE AFAËGJATA TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUAR

Aktivitet afatgjatë të trupezuara dhe të patruhezuara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

Emri i mirë	Programë	Kompjuter	Pajisje informatike server	Rrjet informatik	Rrjet telefonik portabel	Rrjet telefonik	Mobilje	Pajisje Zyre	Instalime dhe pajisje	Totali
<b>Kosto</b>										
Më 31 maj 2018	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	100,146,004	293,140	15,282,877	428,106	239,963	21,953	7,252,911	3,506,763	807,395	27,865,618
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>100,146,004</b>	<b>293,140</b>	<b>15,282,877</b>	<b>428,106</b>	<b>239,963</b>	<b>21,953</b>	<b>7,252,911</b>	<b>3,506,763</b>	<b>807,395</b>	<b>128,011,622</b>
Shtesa	-	2,234,109	-	-	113,852	-	645,106	321,757	633,855	3,948,679
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100,146,004</b>	<b>293,140</b>	<b>17,516,986</b>	<b>428,106</b>	<b>32,510</b>	<b>135,805</b>	<b>7,898,017</b>	<b>3,828,520</b>	<b>1,441,250</b>	<b>131,960,301</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>										
Më 31 maj 2018	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i periudhës	17,449	841,311	37,097	14,284	1,935	1,307	608,453	242,404	23,277	1,787,517
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>17,449</b>	<b>841,311</b>	<b>37,097</b>	<b>14,284</b>	<b>1,935</b>	<b>1,307</b>	<b>608,453</b>	<b>242,404</b>	<b>23,277</b>	<b>1,787,517</b>
Amortizimi i periudhës	41,877	2,193,020	59,394	34,280	4,645	3,841	1,514,139	744,715	225,568	4,821,479
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>59,326</b>	<b>3,034,331</b>	<b>96,491</b>	<b>48,564</b>	<b>6,580</b>	<b>5,148</b>	<b>2,122,592</b>	<b>987,119</b>	<b>248,845</b>	<b>6,608,996</b>
<b>Vlera neto</b>										
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>100,146,004</b>	<b>275,691</b>	<b>14,441,566</b>	<b>391,009</b>	<b>30,575</b>	<b>20,646</b>	<b>6,644,458</b>	<b>3,264,359</b>	<b>784,118</b>	<b>126,224,105</b>
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100,146,004</b>	<b>233,814</b>	<b>14,482,655</b>	<b>331,615</b>	<b>25,930</b>	<b>130,657</b>	<b>5,775,425</b>	<b>2,841,401</b>	<b>1,192,405</b>	<b>125,351,305</b>

## 6.1 AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI

	Ndërtesa	Totali
<b>Kosto</b>		
Më 1 janar 2019	-	-
Shtesa	78,181,880	78,181,880
Pakësime	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>78,181,880</b>	<b>78,181,880</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
Më 1 janar 2019	-	-
Amortizimi i vitit	19,189,553	19,189,553
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>19,189,553</b>	<b>19,189,553</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>		
Më 1 janar 2019	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>58,992,327</b>	<b>58,992,327</b>

## 7. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE ME TO

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogaritë rrjedhëse:		
Në EUR	14,282,238	8,186,384
Në Lekë	310,592	311,880
<b>Totali</b>	<b>14,592,830</b>	<b>8,498,265</b>

Gjendja e mjeteve monetare në bankë më 31 dhjetor 2019 përbëhet nga llogari rrjedhëse të mbajtura pranë bankës OTP në Shqipëri.

## 8. LLOGARI TË ARKËTUSHME

Llogaritë të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	146,663,469	114,581,984
<b>Totali</b>	<b>146,663,469</b>	<b>114,581,984</b>

Llogari të arkëtueshme është e gjitha nga palët e lidhura dhe konsiston në të ardhurat e realizuara nga shitjet ndaj Transcom WorldWide Italy S.P.A.

## 9. SHPENZIME TË SHTYRA

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të shtyra	2,433,085	1,286,701
<b>Totali</b>	<b>2,433,085</b>	<b>1,286,701</b>

Shpenzimet e shtyra konsistojnë në policat e sigurimit. Pjesa që i takon vitit 2020 është njohur si shpenzim i shtyrë.

#### 10. TË ARKËTUESHME TË TJERA

Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH e arkëtueshme	9,820,371	3,764,498
Të arkëtueshme të tjera	-	10,955
<b>Totali</b>	<b>9,820,371</b>	<b>3,775,453</b>

Gjatë vitit 2019 Shoqëria rezulton të ketë TVSH të arkëtueshme në vlerën 9,820,371 Lekë (2018: 3,764,498 Lekë).

#### 11. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14,243,446	2,839,505
Të pagueshme ndaj palëve të treta	9,089,216	7,895,453
<b>Totali</b>	<b>23,332,662</b>	<b>10,734,958</b>

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 lidhet me shërbimet që Shoqëria ka marrë gjatë vitit nga palë të lidhura, për të cilat ende nuk janë kryer pagesat.

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 lidhet kryesisht me shërbimet e konsulencës (kontabël, fiskale dhe auditim), shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, shërbimet e transportit, telefonisë dhe internetit.

#### 12. TË PAGUESHME TË TJERA

Të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme për paga	25,137,849	26,021,807
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	8,444,832	8,585,161
Interes i përlllogaritur	2,204,466	-
Shpenzime të përlllogaritura	2,406,287	1,574,548
Tatim mbi të ardhurat personale	2,160,753	2,133,647
Tatim në burim	72,968	12,539
Të pagueshme të tjera	21,829	47,642
<b>Totali</b>	<b>40,448,365</b>	<b>38,375,344</b>

Shpenzime të përlllogaritura lidhet me shërbimet e marra nga palët e lidhura, për të cilat nuk është marrë ende fatura, dhe faturat e pa-mbërrituara të energjisë elektrike.

Shpenzime interesi të përlllogaritura lidhet me huanë nga Transcom Worldwide Italy e cila është shlyer gjatë 2019.

Tatimi në burim më 31 dhjetor 2019 lidhet me tatimin në burim të paguar të faturës së lëshuar nga Transcom Worldwide Vilnius dhe Transcom Worldwide Philippines për shërbimet e ofruara ndaj Shoqërisë.

“Të pagueshme të tjera” përfaqëson detyrimin që ka shoqëria ndaj punonjësve të saj për rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit.

**Transcom Worldwide Albania sh.p.k.**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Shumat në Lekë)

**13. HUA**

Balanca e huasë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Huamarrje nga Transcom Worldwide Italy	-	117,249,000
Huamarrje nga Transcom Worldwide AB	-	12,342,000
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>129,591,000</u>

Sipas Marrëveshjeve respektive që Shoqëria ka nënshkruar me Transcom Worldwide Italy dhe Transcom Worldwide AB, huaja është dhënë në një formë financimi që këto të fundit i japin Shoqërisë në mënyrë që ajo të përmbushë detyrimet afatashkurtra të saj gjatë aktivitetit operativ me palë të treta. Huaja është shlyer tërësisht gjatë vitit 2019.

**14. DETYRIME QIRAJE**

Detyrimi i qirasë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Detyrimi i qirasë afatshkurtër	18,189,028	-
Detyrimi i qirasë afatgjatë	41,900,448	-
<b>Totali</b>	<u>60,089,476</u>	<u>-</u>

**15. KAPITALI**

Aksionari i Shoqërisë është Transcom WorldWide AB i cili zotëron 100% të kuotave.

**16. TATIM MBI FITIMIN**

Tatim fitimi në Shqipëri është në masën 15% mbi fitimin e tatueshëm. Më poshtë është paraqitur tatim fitimi i pagueshëm për rezultatit më 31 dhejtor 2019.

	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Tatim fitim i pagueshëm	9,801,291	9,554,576
<b>Totali</b>	<u>9,801,291</u>	<u>9,554,576</u>

Rakordimi midis normës efektive të tatimit dhe normës së përdorur për llogaritjen e fitimit për qëllime fiskale është paraqitur më poshtë:

	<b>Norma efektive</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>Norma efektive</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
Fitimi përpara tatimit		185,069,096		76,393,506
Norma e tatimit 15% (2018:15%)	15.00%	27,760,364	15.00%	11,459,026
Shpenzimet e pazbritshme	0.82%	1,518,430	1.47%	1,125,505
Amortizim fiskal shtesë	-1.23%	(2,280,660)	-1.35%	(1,029,955)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin	14.59%	26,998,134	15.12%	11,554,576

### 17. TË ARDHURA NGA KONTRATAT ME KLIENTËT

Të ardhurat nga kontratat me klientët më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga kontratat me klientet	702,784,013	315,752,417
Të ardhura të tjera	42,717	-
<b>Totali</b>	<b>702,826,730</b>	<b>315,752,417</b>

Të ardhura nga kontratat me klientet përfshin të ardhurat e gjeneruara për shërbimet telefonike ndaj Transcom Worldwide Italy S.P.A.

### 18. SHPENZIME PËR PERSONELIN

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime page	370,609,785	178,171,386
Shpenzime për sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	60,030,887	28,885,180
<b>Totali</b>	<b>430,640,672</b>	<b>207,056,566</b>

Shpenzimi i pagës së përfaqësuesve ligjorë të Shoqërisë për vitin 2019 është 936,000 Lekë.

### 19. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzime të tjera operative më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kosto menaxheriale	17,499,043	1,636,787
Shpenzime administrative	16,513,020	8,093,881
Shërbime profesionale dhe konsulence	6,947,568	3,266,061
Shpenzime të tjera	4,606,363	2,213,917
Shpenzime telekomunikimi	2,171,192	854,487
Tarifa bankare	2,116,183	879,435
Shpenzime transporti	1,614,986	799,864
Shpenzime sigurimi	1,513,614	586,699
Shpenzime lidhur me shërbime IT	763,060	-
Liçensë	659,295	470,925
Mirembajtje zyre	541,860	-
Shpenzime kancelarie	169,405	170,190
Taksa të tjera dhe shpenzime doganore	72,821	36,193
Gjoha	7,795	-
Qira zyre	-	9,795,456
<b>Totali</b>	<b>55,196,205</b>	<b>28,803,496</b>

Shërbimet profesionale dhe konsulence përfshijnë tarifën e auditimit në vlerën 794,540 Lekë si edhe tarifën për shërbime fiskale dhe kontabël në vlerën 6,153,028 Lekë. Viti krahasues (2018) paraqet aktivitetin për 7 muaj të Shoqërisë, për këtë arsye edhe kostot e vitit 2019 janë më të larta se viti krahasues.



## 20. SHPENZIME FINANCIARE, NETO

Shpenzimet financiare, neto më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime interesi	4,546,328	2,288,154
Fitim nga kursi i këmbimit	(8,371,791)	(576,821)
Humbje nga kursi i këmbimit	11,735,187	-
<b>Totali</b>	<b>7,909,724</b>	<b>1,711,333</b>

## 21. PALËT E LIDHURA

Përmbledhje e gjendjes dhe transaksioneve me palët e lidhura është paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</b>		
Transcom Europe Holding	7,195,977	-
Transcom Worldwide Philipines	4,444,943	-
Transcom Worldwide Management Services	708,453	2,204,466
Transcom Worldwide Vilnius	703,660	312,919
Transcom Worldwide AB	379,204	72,910
Transcom Worldwide Estoni	307,205	-
Transcom Worldwide Hungary	258,126	-
Transcom Rostock GmbH DE5	245,878	249,210
	<b>14,243,446</b>	<b>2,839,505</b>
<b>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</b>		
Transcom WorldWide Italy	146,663,469	114,581,984
	<b>146,663,469</b>	<b>114,581,984</b>

Asnjë nga balancat me palët e lidhura nuk është e siguruar dhe asnjë shpenzim nuk është bërë i njohur në vitin aktual për borxhet e këqija ose të dyshimta në lidhje me shumat që detyrohen nga palët e lidhura.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka njohur në pasqyrat e saj financiare 1,009,063 Lekë shpenzime të perlllogaritura nga palët e lidhura, për të cilat nuk ka marrë ende faturën.

Tabela në vijim paraqet blerjet dhe shitjet e realizuara gjatë vitit 2019 me palët e lidhura.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Blerje nga palët e lidhura</b>		
Transcom Europe Holding	7,268,448	-
Transcom Worldwide Philipines	4,502,891	-
Transcom Worldwide Management Services	3,435,335	2,204,466
Transcom Worldwide Vilnius	399,263	314,907
Transcom Worldwide AB	308,070	73,808
Transcom Worldwide Estoni	308,419	-
Transcom Worldwide Hungary	267,556	-
Transcom Rostock GmbH DE5	-	251,275
	<b>16,489,980</b>	<b>2,844,457</b>
<b>Shitje ndaj palëve të lidhura</b>		
Transcom WorldWide Italy	701,523,470	313,129,872
	<b>701,523,470</b>	<b>313,129,872</b>
<b>Hua</b>		
Huamarrje nga Transcom Worldwide Italy	-	117,249,000
Huamarrje nga Transcom Worldwide AB	-	12,342,000
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>129,591,000</b>

## **22. ANGAZHIME, GARANCI DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

### *Pasiguria e pretendimeve ligjore*

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

### *Garancitë*

Në datën e këtij raporti Shoqëria nuk ka asnjë garanci për tu shpalosur në keto pasqyra financiare.

## **23. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Në mars të 2020 u shpall gjendja e pandemisë në Shqipëri dhe në botë. Masat e marra nga Qeveria Shqiptare përfshinë kufizime dhe mbyllje të aktiviteteve tregtare. Gjithsesi, masat nuk kanë pasur ndonjë ndikim direkt tek të ardhurat e Shoqërisë. Shoqëria synon të vazhdojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe Drejtimi beson që Shoqëria do të jetë në gjendje të gjenerojë fitime pasi të ardhurat vazhdojnë të rriten.

Gjate vitit 2020 Shoqëria ka pasur një rritje në të ardhura krahasuar me vitin 2019, Pavarësisht situatës së pandemisë, aktiviteti ekonomik ka vazhduar normalisht edhe në rritje përgjatë gjithë 2020 dhe Shoqëria nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në kontratat e saj me klientet, furnitorët apo punonjësit.

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër të rëndësishme pas datës së publikimit të pasqyrave financiare, që kërkon rregullime ose informacione shpjeguese në pasqyrat financiare.